



11

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Ministria e Rendit Publik
Nr. 1532 datë 29.6.2005

Ministria e Drejtësisë
Nr. 464 datë 01.07.2005

Prokuroria e Përgjithshme
Nr. 150 datë 01.07.2005

UDHËZIMI I PËRBASHKËT

Për kushtet, kriteret dhe procedurat e caktimit të masave të përkohshme, të jashtëzakonshme dhe të posaçme të mbrojtjes për dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 8, pikës 4 të nenit 9, pikës 3 të nenit 14, pikës 5 të nenit 10 dhe pikës 5 të nenit 17 të ligjit Nr. 9205, datë 15.3.2004 "Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë",

U D H Ë Z O J M Ë :

KREU I. DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij udhëzimi janë përcaktimi i hollësishëm i kushteve, kriterëve dhe procedurave që duhet të ndiqen për caktimin e masave mbrojtëse për dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë, për personat e afërm ose të lidhur me ta, që u rrezikohet jeta, shëndeti ose prona, për shkak të ndihmës së dhënë në zbatimin e ligjit penal.

2. Në përmbajtje të këtij udhëzimi, përdoren terma të shkurtuar, të cilat u referohen përcaktimeve në vijim:

- Dëshmitar - dëshmitar i drejtësisë;
- Bashkëpunëtor - bashkëpunëtor i drejtësisë

- Person i mbrojtur - dëshmitar, bashkëpunëtor, ose person i afërt apo i lidhur me ta;
- Komisioni - Komisioni i Vlerësimit të Masave të Posaçme të Mbrojtjes të Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë;
- Sektori - Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë në përbërje të Drejtorinë e Luftës kundër Krimit të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve, në Ministrinë e Rendit Publik;
- Drejtues i Prokurorisë - Drejtuesi i Prokurorisë për Krime të Rënda, Prokurorët e Rretheve Gjyqësore dhe Prokurorët e Apelit;

3. Masa të zakonshme të mbrojtjes janë masat për sigurimin e jetës, shëndetit dhe pasurisë së personit, që parashikohen në ligjin dhe në aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit.

KREU II. KUSHTET PËR CAKTIMIN E MASAVE TË POSAÇME TË MBROJTJES

4. Kur masat e zakonshme të mbrojtjes çmohen si të papërshtatshme apo të pamjaftueshme për sigurimin e jetës, shëndetit apo pronës së dëshmitarit ose bashkëpunëtorit, ndaj tij zbatohen masa të posaçme të mbrojtjes.

Masat e posaçme nuk mund të vendosen e zbatohen nëse nuk ekziston gjendja e rrezikut aktual, konkret e serioz.

5. Me gjendje rreziku aktual kuptohet një situatë në zhvillim e sipër, e cila vazhdon të rrezikojë jetën, shëndetin apo pronën e dëshmitarit ose bashkëpunëtorit të drejtësisë.

Gjendja e rrezikut nuk duhet të ketë kaluar dhe as të supozohet se mund të ndodhë në të ardhmen.

6. Me gjendje rreziku konkret kuptohet situata kur elemente të veçantë të këtij rreziku kanë filluar të shfaqen dhe mund të shkallëzohen në veprime konkrete kundër dëshmitarit ose bashkëpunëtorit.

7. Me gjendje rreziku serioz kuptohet ajo situatë kur jeta, shëndeti apo prona e dëshmitarit ose bashkëpunëtorit kanosen në mënyrë të

tillë që, nëse nuk do të merreshin masat e duhura, do t'iu shkaktonte një dëm i rëndësishëm,

8. Masat e posaçme vendosen dhe zbatohen kur deklaratimet para prokurorit ose policisë gjyqësore, dëshmia ose deklaratimet e dhëna para gjykatës, ose nënshkrimi i çdo akti tjetër në përputhje me ligjin procedural penal, pa vendosur kushte apo rezerva për përmbajtjen apo përdorshmërinë e tyre, vlerësohet shumë e rëndësishme për:

- a) sigurimin e burimeve të provës apo provave pa të cilat mund të vihej në dyshim një akuzë ose vendim fajësie ndaj të akuzuarve;
- b) zbulimin e bashkautorëve të tjerë në kryerjen e krimit objekt hetimi apo gjykimi;
- c) arrestimin e personit ndaj të cilit është lëshuar urdhri i ndalimit apo është vendosur masa e sigurimit "arrest në burg";
- d) zvogëlimin e dukshëm të pasojave të shkaktuara nga krimi apo parandalimin e krimeve në përgatitje e sipër;
- e) zbulimin e aseteve kriminale të të akuzuarve apo personave të lidhur me ta;
- f) krijimin e mundësive për shpërblimin e dëmit të shkaktuar të dëmtuarit nga vepra penale ose trashëgimtarëve të tij;
- g) rishikimin e vendimeve që kanë marrë formën e prerë;

Masat e posaçme mund të vendosen para ose pas marrjes së të dhënave nga dëshmitari ose bashkëpunëtori.

9. Masat e posaçme të mbrojtjes nuk mund të vendosen dhe zbatohen kur personi përfitues nuk pranon t'iu nënshtrohet këtyre masave ose nuk shpreh vullnetin që të bashkëpunojë për realizimin e tyre.

Akti i shprehjes së vullnetit duhet të jetë akt i shkruar.

10. Persona të afërm të dëshmitarit ose bashkëpunëtorit konsiderohen personat të përcaktuar të tilla në baze të nenit 2 të ligjit nr. 9205, datë 15.03.2004 "Për Mbrojtjen e Dëshmitareve dhe Bashkëpunëtoreve të Drejtësisë".

11. Persona të lidhur të dëshmitarit ose bashkëpunëtorit konsiderohen personat fizikë ose juridikë për të cilët rezultojnë të dhëna të

mjaftueshme qe provojnë se pasuritë apo veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthorte, nga vetë dëshmitari ose bashkëpunëtori.

KREU III. PROCEDURA E MARRJES SE VENDIMIT

12. Prokurori që drejton hetimet paraprake ose që mbron akuzën në gjyq, në rastet kur ka informacione të bazuara ose çmon se, për shkaqe që lidhen me deklaratimet para prokurorit ose policisë gjyqësore, dëshminë ose deklaratimet e dhëna para gjykatës, ose për shkak të nënshkrimit të çdo akti tjetër në përputhje me ligjin procedural penal, dëshmitari ose bashkëpunëtori duhet të merret në mbrojtje të posaçme, njofton me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë.

Njoftimi ka formën e një relacioni shpjegues për situatën e rrezikut, të cilit i bashkëlidhen:

- a) kopje e njësuar me origjinalin e deklaratimeve apo e dëshmisë së dhënë;
- b) informacionet e mundshme të policisë gjyqësore për gjendjen e rrezikut;
- c) certifikatat e lindjes dhe të gjendjes familjare të personit apo personave që propozohen të merren në mbrojtje;
- d) çdo dokument tjetër që çmohet i nevojshëm.

Drejtuesi i Prokurorisë kur çmon se situata e rrezikut është aktuale, konkrete dhe serioze, i përcjell aktet Prokurorit të Përgjithshëm, duke i kërkuar që të propozojë masa të posaçme mbrojtje.

13. Prokurori i Përgjithshëm i propozon Komisionit që të caktojë masa të posaçme të mbrojtjes për dëshmitarin dhe bashkëpunëtorin.

Propozimi i Prokurorit të Përgjithshëm shoqërohet me parashtrimin e të dhënave në vijim:

- a) gjeneralitetet, gjendjen familjare, vendbanimin dhe çdo të dhënë tjetër që shërben për identifikimin e personit që propozohet të merret në mbrojtje;

- b) të dhëna që përcaktojnë të ardhurat personale dhe familjare, si dhe pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që zotëron ai, ose personat e afërm apo të lidhur me të;
- c) numrin e procedimit ose të çështjes në gjykim, gjeneralitetet e personave të akuzuar me akuzat përkatëse, gjeneralitetet e personit të dëmtuar, gjendjen dhe shkallën e procedimit;
- d) përcaktimin e elementëve mbi bazën e të cilëve gjykohet se kallëzimi, deklaratimet apo dëshmia e personit janë të një rëndësie të posaçme për çështjen objekt hetimi apo gjykimi;
- e) përcaktimin e elementëve mbi bazën e të cilëve gjykohet se personi ndodhet në situatë rreziku aktual, konkret e serioz që lidhet me të dhënat e ofruara prej tij;
- f) përcaktimin e të dhënave për personat e tjerë të mundshëm që duhet të merren njëkohësisht në mbrojtje dhe lidhjen e tyre me personin në fjalë;
- g) masën konkrete të mbrojtjes së posaçme që gjykohet si më e përshtatshme për rastin konkret;
- h) propozimin e mundshëm për marrjen e masave të përkohshme të mbrojtjes, për shkaqe të ngutshme;
- i) çdo të dhënë tjetër që çmohet e nevojshme.

Prokurori i Përgjithshëm mund të rezervohet në dhënien e informacioneve të mësipërme, duke arsyetuar nevojën për ruajtjen e sekretit të hetimeve, përderisa me të dhënat nuk është njohur i pandehuri ose mbrojtësi i tij.

14. Propozimi i Prokurorit të Përgjithshëm depozitohet në Sektorin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë. Ai protokollohet në një regjistër të posaçëm. Numri i protokollit, data dhe ora e mbërritjes në Sektor shënohen në shkresën përcjellëse, së bashku me nënshkrimin e protokolluesit,

15. Jo më vonë se 3 ditë nga mbërritja e propozimit, Sektori përgatit materialet që do të merren në shqyrtim nga Komisioni. Propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm i bashkëlidhet një relacion i vlerësimit të gjendjes nga Sektori, me sugjerimet konkrete për zgjidhjen më të përshtatshme.

Materialet i paraqiten Kryetarit të Komisionit, i cili ia cakton për relatin njërit prej anëtarëve.

Kryetari cakton ditën e mbledhjes jo më vonë se 2 ditë nga data e paraqitjes së materialeve nga Sektori,

Deri në datën e mbledhjes, relatori ka të drejtë të kërkojë të dhëna shtesë ose sqarime nga Shefi i Sektorit ose specialisti i ngarkuar me ndjekjen e rastit konkret.

16. Rasti objekt shqyrtimi relatohet nga anëtari i ngarkuar prej Kryetarit.

Kryetari i Komisionit dhe anëtarët e tjerë kanë të drejtë të bëjnë pyetje dhe të kërkojnë sqarime.

Lejohet pjesëmarrja në mbledhje e Shefit të Sektorit dhe specialistit që ndjek praktikën e propozuar.

Diskutimet e anëtarëve të Komisionit dhe vendimi i marrë pasqyrohen në protokollin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga Kryetari dhe punonjësi që mban procesverbalin.

17. Në rastet kur në përmbajtje të propozimit dhe të dokumentacionit shoqërues Komisioni konstaton paqartësi lidhur me ekzistencën e situatës së rrezikut, mund t'i kërkojë Prokurorit të Përgjithshëm të dhëna plotësuese, duke parashtruar faktet për të cilat kërkon sqarime.

Nuk lejohet kërkimi i të dhënave plotësuese më shumë se njëherë, Pas plotësimit të tyre Komisioni është i detyruar të shprehet me vendim.

18. Komisioni shprehet me vendim pranimi ose refuzimi, i cili duhet të arsyetohet.

Vendimi shkruhet nga relatori dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit dhe nga Kryetari.

Vendimit i bashkëlidhet mendimi i mundshëm i pakicës.

Për pranimin ose refuzimin e vendimit, si dhe në zgjedhjen e llojit të masës së mbrojtjes së posaçme, Komisioni mban parasysh rëndësinë e të dhënave të siguruara nga personi që merret në mbrojtje, objektin dhe shkallën e rrezikut , rrezikshmërinë

shoqërore të personave të akuzuar, gjendjen familjare e financiare, vendbanimin dhe çdo faktor ndikues për zgjedhjen e masës më të përshtatshme.

Vendimi i njoftohet shkresërisht Prokurorit të Përgjithshëm.

Vendimi i njoftohet edhe personit të marrë në mbrojtje të posaçme, kundrejt nënshkrimit dhe shënimit të datës së marrjes dijeni në vendim.

Prokurori i Përgjithshëm i dërgon pa vonesë kopje të vendimit Drejtuesit të Prokurorisë që ndjek çështjen.

19. Me depozitimin e vendimit, Sektori merr masa të karakterit teknik dhe organizativ për të përgatitur dhe nënshkruar marrëveshjen e mbrojtjes, brenda afatit kohor që cakton neni 16.1 i ligjit.

Përgatitja e marrëveshjes paraprihet nga bisedime me personin e marrë në mbrojtje.

Sektori merr masa dhe dokumenton njoftimin për pjesëmarrje në bisedime të prokurorit që ndjek çështjen.

Personi i mbrojtur njihet me vendimin dhe modalitetet e zbatimit të tij dhe ftohet të plotësojë formularin e të dhënave.

Gjatë bisedimeve personi i marrë në mbrojtje mund të paraqitë kërkesa, të cilat mund të plotësohen vetëm nëse nuk vijnë në kundërshtim me ligjin.

20. Formulari i të dhënave përgatitet nga Sektori dhe përmban disa rubrika, ku pasqyrohen në mënyrë të detajuar të dhënat në vijim:

- a) gjeneralitetet e personit të marrë në mbrojtje dhe të familjarëve të tij;
- b) të dhëna të gjendjes shëndetësore;
- c) të dhëna për pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme që zotëron individualisht apo në bashkëpronësi;
- d) të dhëna për arsimimin, kryerjen e shërbimit ushtarak, eksperiencat profesionale;
- e) detajimin e të ardhurave financiare;

- f) të dhëna për procedimet penale apo konflikte civile, të zgjidhura me vendim të formës së prerë ose në proces;
- g) të dhëna të tjera me interes.

Detajimi i të ardhurave financiare duhet të pasqyrohet për pesë vitet e fundit.

Formulari plotësohet në kopje të vetme dhe administrohet në Sektor.

Sektori ka të drejtë të bëjë verifikimet e nevojshme për saktësinë e të dhënave të deklaruara.

21. Sektori përgatit marrëveshjen e mbrojtjes, ku parashikohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Përpara se të nënshkruhet, marrëveshja e mbrojtjes vihet në dispozicion të prokurorit që ndjek çështjen, i cili jep pëlqimin me shkrim për nënshkrimin e saj.

Prokurori nuk mund të pengojë nënshkrimin e marrëveshjes për shkaqe që nuk janë biseduar në Komision, përveç rastit kur ai ka marrë dijëni për to pas marrjes së vendimit. Në këtë rast, kundërshtimet e prokurorit Sektori ia paraqit për vlerësim Komisionit.

22. Komisioni mblidhet dhe merr në shqyrtim kundërshtimet e prokurorit jo më vonë se tre ditë nga paraqitja e tyre. Prokurori ftohet të marrë pjesë.

Pasi dëgjon prokurorin dhe i merr mendim Sektorit, Komisioni vendos për zbatimin e marrëveshjes ose për riformulimin e termave të saj.

KREU IV. PËRMBAJTJA E MARRËVESHJES SE MBROJTJES DHE NDJEKJA E ZBATIMIT TE SAJ

23. Marrëveshja e mbrojtjes është një kontratë me detyrime të dyanshme, e lidhur me vullnet të lirë dhe te pavesuar, me palë kontraktuese Sektorin dhe personin e mbrojtur.

Kjo marrëveshje përmban detyrimisht të drejtat e detyrimet e palëve, kohëzgjatjen e zbatimit të masave dhe rrethanat e ndryshimit apo të heqjes së tyre.

Ajo hartohet në kopje të vetme që ruhet në Sektor.

24. Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe mbaron në rastet e mëposhtme:

- a) kur mbaron afatit i parashikuar në marrëveshje;
- b) kur personi I mbrojtur ose Sektori pas miratimit nga Komisioni tërhiqet në mënyrë të njëanshme;
- c) kur vdes personi i mbrojtur;
- d) kur përfundon gjendja e rrezikut për të cilin është marrë masa e posaçme e mbrojtjes.

Vdekja e personit të mbrojtur nuk paragjykon vazhdimin e zbatimit të marrëveshjes për personat e afërt ose të lidhur me të.

Për mbarimin e marrëveshjes njoftohet me shkrim prokurori.

25. Para fillimit të zbatimit të masave të posaçme të mbrojtjes, Sektori i bën të njohura edhe njëherë personi të mbrojtur të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga programi i mbrojtjes, pasojat në rast shkelje të marrëveshjes dhe i kërkon që të nënshkruajë deklaratën e mëposhtme:

"Deklaroj se jam në dijeni të plotë të marrëveshjes për mbrojtjen dhe të të drejtave e detyrimeve që burojnë prej saj. Jam sqaruar hollësisht për kuptimin e dispozitave të veçanta të kësaj marrëveshje dhe zotohem ta zbatoj atë me korrektësi Jam plotësisht dakord me përmbajtjen e saj, fakt të cilin e vërtetoj duke nënshkruar këtë deklaratë."

26. Sektori ka këto të drejta dhe detyrime:

- a) të marrë të gjitha masat e nevojshme me karakter teknik e organizativ për të ofruar mbrojtje të përshtatshme, në përputhje me shkallën dhe nivelin e rrezikut;
- b) të mbikëqyrë në vijimësi respektimin e kushteve të' marrëveshjes;
- c) të mbajë kontakte të vazhdueshme me personin e mbrojtur;

- d) të sigurojë kushtet për plotësimin e të gjitha kërkesave të ligjshme të personit të mbrojtur;
- e) t'i ofrojë falas shërbime mjekësore të zakonshme dhe të specializuara nëpërmjet shërbimit të posaçëm në Ministrinë e Rendit Publik;
- f) të sigurojë marrjen e masave që personi i mbrojtur të përmbushë detyrimet e tij ndaj organeve të drejtësisë, duke siguruar zhvendosjen, transportimin dhe akomodimin e tij në kohën e duhur.

Personi i mbrojtur ka këto të drejta e detyrime:

- a) të pranojë t'iu nënshtrohet masave që Sektori i çmon të nevojshme për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe pronës së tij;
- b) të kallëzojë, deklarojë dhe dëshmojë me vërtetësi para policisë gjyqësore, prokurorit dhe gjykatës, sa herë që të jetë e nevojshme, pa kushte e rezerva, lidhur me faktet objekt hetimi apo gjykimi për të cilat ka dijeni;
- c) të ruajë sekretin lidhur me të gjitha faktet për të cilat ka marrë dijeni gjatë zbatimit të programit të mbrojtjes, edhe pas tërheqjes apo mbarimit të tij;
- d) të ndërpresë menjëherë kontaktet me personat e dyshuar për veprimtari kriminale, si dhe me persona të tjerë, takimet me të cilët mund të rrezikojnë programin e mbrojtjes;
- e) të mos kryejë veprimtari që e ekspozojnë ndaj rrezikut, apo që bien ndesh me qëllimet e zbatimit të programit të mbrojtjes;
- f) të mos keqpërdorë dokumentet mbuluese dhe të njoftojë menjëherë Sektorin, në rast humbje apo vjedhje të tyre;
- g) të bëjë përpjekje për të shlyer të gjitha detyrimet ndaj personave fizikë ose juridikë, të mbartura prej tij para përfshirjes në programin e mbrojtjes;
- h) të mos keqpërdorë programin e mbrojtjes për të mbuluar pjesëmarrjen në veprimtari kriminale;
- i) të pranojë që të bashkëpunojë me Sektorin, në interes të mbrojtjes së tij, duke ndihmuar për zbatimin e masave të përshtatshme teknike që realizojnë vëzhgimin, përgjimin e bisedimeve dhe komunikimeve telefonike apo elektronike, si dhe kontrollin dhe manipulimin e korrespondencës së tij me persona të tretë;
- j) të bëjë përpjekje për të siguruar të ardhurat e nevojshme për përballimin e jetesës;
- k) të ekonomizojë ndihmën financiare të ofruar nga Sektori, pa lejuar shpenzime të panevojshme apo të tepërta;

- 1) të respektojë masat e marra nga autoritetet e huaja kur zbatimi i programit të mbrojtjes kryhet në territorin e një shteti tjetër.

27. Ndjekja e zbatimit të programit të mbrojtjes kryhet nga Sektori, Përcurinë e zbatimit të programit Sektori informon Komisionin, jo më pak se një herë në tre muaj.

28. Masat e posaçme të mbrojtjes mund të ndryshohen ose të hiqen, kur personi i mbrojtur shkel një ose disa nga kushtet e marrëveshjes së mbrojtjes, të parashikuara shprehimisht në përmbajtje të saj, kur pushojnë shkaqet që kanë diktuar lidhjen e saj, si dhe me kërkesën e tij.

29. Sektori i kërkon Komisionit ndryshimin ose heqjen e masave, duke parashtruar arsyet ku mbështetet kërkesa,

Kërkesa shoqërohet me gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Ajo paraqitet jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes dijeni për shkeljen e kryer, e konstatimit të shkakut që dikton ndryshimin, apo e depozitimit të kërkesës nga personi i interesuar.

Komisioni merr në shqyrtim kërkesën jo më vonë se 5 ditë, duke filluar nga e nesërmja e paraqitjes së saj.

Zbatohen, për aq sa është e mundur, rregullat e parashikuara në nenet 15 - 18 të këtij udhëzimi.

30. Sektori mund t'i propozojë Komisionit heqjen e masave mbrojtëse, në rastet e mëposhtme:

- a) kur mbaron afati i parashikuar në marrëveshje dhe nuk janë kushtet për zgjatjen e vlefshmërisë së saj;
- b) kur pushojnë shkaqet e rrezikut që kanë diktuar lidhjen e saj;
- c) kur personi i mbrojtur refuzon të deklarojë apo të dëshmojë ose kur nga verifikimi i thënieve të tij del se ka bërë kallëzim, deklarime apo dëshmi të rremë;
- d) kur gjatë ripyetjes ndryshon përmbajtjen e kallëzimit, deklarimit ose dëshmisë së dhënë;
- e) kur pas fillimit të zbatimit të programit të mbrojtjes, ndaj tij ngrihet akuzë për një vepër penale, të kryer me dashje, gjatë kohës që është nën mbrojtje;
- f) kur pas fillimit të zbatimit të programit të mbrojtjes, ndaj tij ngrihet akuzë për një vepër penale, të kryer me dashje, para se të

- kishte filluar programi i mbrojtjes, por të padeklaruar në shpjegimet e tij;
- g) kur provohet se ka paraqitur të dhëna të rreme lidhur me të pasuritë dhe të ardhurat financiare; h) kur refuzon të bashkëpunojë me Sektorin për zbatimin e marrëveshjes së mbrojtjes;
 - h) kur refuzon masat e marra nga Sektori me qëllim sigurimin e jetës, shëndetit dhe pronës së tij dhe të të afërmeve të tij;
 - i) kur kryen veprime që përbëjnë rrezik për të dhe për të afërmit e tij, ndonëse është këshilluar nga Sektori për ndërprerjen e tyre;
 - j) kur refuzon ose braktis, pa shkaqe të arsyeshme, punën e ofruar apo veprimtaritë që sjellin të ardhura ekonomike;
 - k) kur autoriteti i huaj njofton mbarimin e masave të zbatuara prej tij dhe nuk çmohet se duhet të merren masa mbrojtëse në territorin e Republikës së Shqipërisë.

31. Sektori mund t'i propozojë Komisionit ashpërsimin apo zbutjen e masave mbrojtëse, në rastet kur ndryshojnë kushtet që kanë diktuar marrjen e tyre.

32. Personi që u është" nënshtruar masave mbrojtëse të posaçme, mund t'i kërkojë Sektorit ndryshimin ose heqjen e tyre, duke parashtruar motivet ku mbështetet kërkesa.

Kërkesa shqyrtohet nga Komisioni, i cili merr vendim për pranimin ose refuzimin e saj,

33. Vendimi për ndryshimin apo heqjen e masave mbrojtëse të posaçme i njoftohet prokurorit jo më vonë se tre ditë, duke filluar nga e nesërmja e marrjes së vendimit.

KREU V. LLOJET E MASAVE TE POSAÇME TE MBROJTJES

34. Ndryshimi i identitetit është mase e posaçme mbrojtje e cila konsiston në pajisjen e personit të mbrojtur dhe familjes së tij me dokumente identifikimi të ndryshuara.

Për realizimin e kësaj mase Sektori bashkëpunon me entet shtetërore e private për të siguruar përgatitjen e dokumenteve fiktive, regjistrimet përkatëse ne regjistrin themeltar të shtetasit në Zyrat e Gjendjes Civile,

si dhe ndryshimet përkatëse në' dokumentacionin e çdo zyre tjetër.

Të drejtat dhe detyrimet e Sektorit dhe të enteve shtetërore e private rregullohen me marrëveshje të veçanta.

Ndryshimet në identitetin e personit të mbrojtur dhe familjarëve të tij pasqyrohen në një regjistër të veçantë, i cili ruhet në Sektor.

35. Ndryshimi i vendbanimit është masë e posaçme mbrojtje e cila konsiston në zhvendosjen e personit të mbrojtur dhe familjes së tij nga vendbanimi i njohur drejt një vendbanimi të ri, brenda të njëjtit rreth, në një rreth tjetër, ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Shpenzimet e zhvendosjes dhe pagimi i qirasë së banesës përballohen nga fondi i Sektorit.

Në rastet e zhvendosjes jashtë shtetit shpenzimet caktohen në marrëveshje me palën pritëse.

36. Mbrojtja e përkohshme e identitetit është masë e posaçme mbrojtje e cila konsiston në fshehjen e gjeneraliteteve të personit të mbrojtur në fazën e hetimeve paraprake, si dhe gjatë dhe pas shqyrtimit gjyqësor të çështjes.

Për realizimin e kësaj mase, Sektori bashkëpunon me prokurorin, duke i dhënë personit një identitet fiktiv, me ose pa regjistrim në regjistrat e Zyrës së Gjendjes Civile. Ndryshimet pasqyrohen në regjistrin e posaçëm të Sektorit.

Sektori merr masa që gjatë dëshmisë së tij, personi i mbrojtur të jetë i shoqëruar fizikisht. Mund të merren masa për ndryshimin e pamjes fizike,

Lejohet përdorimi i aparaturave që realizojnë ndryshimin e zërit.

37. Me masa të mbrojtjes fizike kuptohet tërësia e masave për të siguruar mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe pronës së personit të marrë në mbrojtje dhe njerëzve të afërt apo të lidhur me të.

Për sigurimin e mbrojtjes fizike, lejohet përdorimi i mjeteve teknike të interceptimit dhe vëzhgimit.

Për përmbushjen e detyrimeve ndaj drejtësisë personi i mbrojtur lëviz i shoqëruar nga Reparti Special i Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe Personave të Veçantë.

38. Masa të posaçme të karakterit financiar janë:

- a) kontributi për pagimin e qirasë së banesës;
- b) kontributi për mbulimin e shpenzimeve për transferimin;
- c) kontributi për mbulimin e nevojave të familjes derisa personi i mbrojtur dhe familjarët e tij të gjejnë një punë të re;
- d) kontributi për rikualifikimin profesional;
- e) kontributi për pagesat e ndihmës ligjore.

39. Shpenzimet e karakterit financiar duhet të përlligjen me paraqitjen e faturës. Kur kjo nuk është e mundur, për shkaqe që lidhen me sigurinë e personit apo për shkaqe të tjera të arsyeshme, mjafton deklarimi i shpenzimeve i miratuar nga Shefi i Sektorit.

Tërheqja e të hollave në arkë nuk duhet t'i referohet personit të mbrojtur. Në çdo rast përdoret një kod i paracaktuar.

Dokumentacioni dhe kodi i zgjedhur vendosen në fashikullin e praktikës, së bashku me aktet që kanë vendosur, zgjatur apo ndryshuar masat e posaçme të mbrojtjes.

Paguhet shpenzimet për kryerjen e kurseve të kualifikimit kur, për shkaqe që lidhen me mbrojtjen e personit apo me rrethana të tjera, personi nuk mund të ushtrojë dot profesionin e mëparshëm.

Paguhet të gjitha shpenzimet e domosdoshme që kryhen me qëllim rehabilitimin dhe reintegrimin shoqëror të personit të mbrojtur dhe të personave të afërm ose të lidhur me të, të vendosur në program mbrojtje.

Paguhet shpenzimet e kryera për mbrojtjen ligjore. Kjo e drejte nuk mund të ushtrohet në rastet e proceseve penale, civile apo administrative që nuk kanë lidhje me faktin për të cilin personi është marrë në mbrojtje.

Lejohet pagesa e shpenzimeve për konsultime juridike dhe për ndihmën psikologjike të personit të mbrojtur, i cili thirret të dëshmojë në gjyq.

Ndihmë psikologjike mund t'i ofrohet edhe bashkëpunëtorit të drejtësisë.

40. Masat mbrojtëse për personat e paraburgosur apo që vuajnë dënimin me burgim ekzekutohen në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Lejohet mbajtja e personit të mbrojtur në regjim të veçantë, pa lejuar kontakt fizik me personat e paraburgosur ose të dënuar.

Lejohet transferimi i personit të mbrojtur për shkaqe sigurie.

Personi në regjim mbrojtje mund të përfitojë takime jashtë radhe me familjarët e tij dhe lehtësi të tjera që parashikojnë rregulloret,

Zbatimi i masave të posaçme të mbrojtjes për personat e paraburgosur ose të dënuar mbikëqyret nga prokurori.

KREU VI. MASAT E PËRKOHSHME TE MBROJTJES

41. Masat e përkohshme të mbrojtjes janë masa që merren për shkaqe të ngutshme, me afat të caktuar dhe që ekzekutohen menjëherë, me qëllim që të sigurojnë paraprakisht nivelin e domosdoshëm të mbrojtjes për jetën, shëndetin dhe prona e personit të mbrojtur, deri në vendosjen e masave të posaçme të mbrojtjes.

42. Masat e përkohshme të mbrojtjes vendosen nga Sektori me kërkesë të arsyetuar të Drejtuesit të Prokurorisë ku është regjistruar procedimi, në të cilin personi që kërkohet të merret në mbrojtje ka cilësinë e dëshmitarit apo të bashkëpunëtorit të drejtësisë.

Sektori shprehet me vendim të arsyetuar jo më vonë se 24 orë nga data e regjistrimit të kërkesës.

Vendimi i Sektorit nuk është i vlefshëm pa pëlqimin paraprak, të dhënë me shkrim, nga personi që do të mbrohet.

Vendimi i Sektorit nuk mund të vihet në ekzekutim pa miratimin e njëkohshëm të Kryetarit të Komisionit dhe të Prokurorit të Përgjithshëm ose të një prokurori të autorizuar prej tij.

43. Masa të përkohshme të mbrojtjes janë:
- a) shoqërimi për mbrojtjen e afërt fizike;
 - b) marrja në ruajtje e banesës ose e pronës.

Mbrojtje të përkohshme, në varësi nga kushtet e rrezikut, mund të përfitojnë edhe personat e afërt ose të lidhur me personin e mbrojtur.

Mbrojtja e personit dhe e pronës së tij, në varësi nga kushtet e rrezikut, kryhet për intervale të caktuara kohore ose në mënyrë të pandërprerë gjatë 24 orëve.

44. Masat e përkohshme të mbrojtjes nuk mund të zgjatin më shumë se 30 ditë.

Brenda këtij afati kohor Komisioni duhet të marrë vendim për caktimin e masave të posaçme të mbrojtjes, pas propozimit të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm.

Masat e përkohshme mbarojnë me vendosjen e masave të posaçme të mbrojtjes.

KREU VII. MASAT E JASHTËZAKONSHME TE MBROJTJES

45. Masat e jashtëzakonshme të mbrojtjes janë masa që merren për shkaqe të ngutshme, me afat të caktuar dhe që ekzekutohen menjëherë, me qëllim që të sigurojnë paraprakisht nivelin e domosdoshëm të mbrojtjes për jetën, shëndetin dhe pronën e shtetasve, të paraburgosurve ose të dënuarve, deri në vendosjen e masave të posaçme të mbrojtjes.

46. Masat e jashtëzakonshme të mbrojtjes vendosen nga Policia e Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e institucioneve të paraburgimit apo të vuajtjes së dënimit.

Ato i njoftohen menjëherë dhe jo më vonë se 24 ore nga marrja e tyre Drejtuesit të Prokurorisë që ndjek çështjen dhe Sektorit.

Vendimi për caktimin e tyre duhet të jetë i arsyetuar

47. Masa të jashtëzakonshme të mbrojtjes janë masat e parashikuara nga nenet 41 dhe 44 të këtij udhëzimi, si dhe çdo masë tjetër e parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e organeve që kanë të drejtë të vendosin këto masa.

48. Masat e jashtëzakonshme të mbrojtjes nuk mund të zgjatin më shumë se 15 ditë. Me të drejtë rizgjatje për një periudhë tjetër 15 ditore.

Zgjatja e afatit duhet të miratohet nga Sektori dhe prokurori i çështjes.

Brenda këtij afati kohor Komisioni duhet të marrë vendim për caktimin e masave të posaçme të mbrojtjes.

Masat e jashtëzakonshme mbarojnë:

- a) kur zhduket gjendja e rrezikut që ka diktuar marrjen e tyre;
- b) kur vendosen e masa të posaçme të mbrojtjes.

KREU VIII. HYRJA NE FUQI

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


MINISTRI I RENDIT PUBLIK
Igli TOSKA
 TIRANE


MINISTRI I DREJTËSISË
Fatmir XHAFI
 TIRANE


PROKURORI I PERGJITHSHEM
Theodhori SOLLAKU
 TIRANE


REPUBLICA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

